



REPUBLIKA KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO	
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/ PROCUREMENT REVIEW BODY	
Nr/Bn	510/15
Date/Datum	28.12.2015
PRISHTINË - PRISTINA	



REPUBLIC OF KOSOVO  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/ PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. Nr. 510/15

**PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT** i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Hysni Hoxha-Kryetar, z. Ekrem Salihu – Referues, z. Tefik Sylejmani – anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “**Astra Plan**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Vazhdimi i ndërtimit të QMF-së, në Bair-Mitrovicë”**, me nr. të Prokurimit: 206/15/049/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë (MSH)**, me votim unanim, më: 18.12.2015, mori këtë :

**V E N D I M**

**MBI APROVIMIN E ANKESËS SË OE “ASTRA PLAN”, SI TË BAZUAR.**

**I. Aprovohet**, ankesa e OE “**Astra Plan**”, lidhur me procedurën e prokurimit me titull **“Vazhdimi i ndërtimit të QMF-së, në Bair-Mitrovicë”**, me nr. të Prokurimit: 206/15/049/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë (MSH)**, si e bazuar.

**II. Anulohet**, vendimi i autoritetit kontraktues - **Ministria e Shëndetësisë (MSH)**, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: **“Vazhdimi i ndërtimit të QMF-së, në Bair-Mitrovicë”**, me nr. të Prokurimit: 206/15/049/521, si i pa bazuar.

**III. Urdhërohet**, autoritetit kontraktues - **Ministria e Shëndetësisë (MSH)**, që procedurën e prokurimit me titull **“Vazhdimi i ndërtimit të QMF-së, në Bair-Mitrovicë”**, me nr. të Prokurimit: 206/15/049/521, ta kthej në Ri-vlerësim, dhe ne afat prej 10 ditësh ta njoftoj me shkrim panelin shqyrtues lidhur me zhvillimin e procedurave te prokurimit.

**I.V.** Mos respektimi i këtij vendimi e detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore nenit 25.8 dhe 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj autoritetit kontraktues.

**V.** Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues “**Astra Plan**”, janë të qëndrueshme, konform nenit 118.3 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës në shumë prej 500.00 € (pesëqind euro).

## **A r s y e t i m**

Operatori ekonomik “Astra Plan” - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP më 19.11.2015, me nr. të protokollit, 510/15, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE “Termontimi” - Prishtinë, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së.

Organji Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së nr. 04/L-042, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmérinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues, në raportin e ekspertizës ka konstatuar se, OE ankues nuk i ka ofruar dy referenca (sipas 9.1.4 – evidencës nr.4), me vlerë prej 50,000.00 euro, në punë të kryera në objekte shëndetësore, mirëpo eksperti shqyrtues ka konstatuar se OE ankues “Astraplan”, kontratën dhe referencën të cilën e ka dorëzuar në ofertë, e ka plotësuar kërkesën përfaktin se vlera e kësaj kontrate dhe reference është 126,225.84 euro.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë i ka propozuar panelit shqyrtues që të anulohet vendimi i AK-së, për dhënie të kontratës, ndërsa ankesën e OE ankues ta aprovoj si të bazuar.

OE ankues “Astra Plan”, në parashtresën e 16.12.2015, ka deklaruar se, pajtohet me mendimin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

AK-ja, me 15.12.2015, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me raportin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, më 18.12.2015, në të cilën ishin prezent anëtarët e Panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesi i autorizuar i OE ankues si dhe përfaqësuesi i AK-së. Në seancë u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i iniciimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës si dhe parashresa e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Gjatë prezantimit në seancë, përfaqësuesi i autorizuar i OE ankues “Astra Plan” deklaroj: Pas shpalljes së njoftimit për kontratë kemi shpreh interesim të marrim pjesë në këtë aktivitet të prokurimit, ku me 29.10.2015, kemi dorëzuar ofertën tonë dhe njëherit sipas raportit të hapjes kemi qenë me çmim më të lirë. Me datë 13.11.2015, na dërgohet përmes emailit, njoftimi mbi eliminimin dhe njoftimi për dhënie të kontratës njëkohësisht.

Arsyeja e eliminimit sipas AK-së, ka qenë se ne nuk kemi prezantuar së paku dy referenca sipas kërkesës së tyre në objekte shëndetësore me vlerë minimale 50.000€.

Lidhur me këtë, ne kemi kërkuar qasje në dokumente zyrtare che AK-ja, na ka ofruar qasje sipas kërkesës dhe gjatë shqyrtimit të ofertës së dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë kemi vërejtur se i njëjtë nuk i plotëson kushtet dhe kërkesat sipas dosjes së tenderit, përkatësisht kriterin për të cilin ne jemi eliminuar, si OE i shpallur fitues nga komisioni i ka të panoterizuara referencat dhe pranimet teknike, e që kërkesë e AK-së, ka qenë dhe është kërkuar që decidivisht “Original ose kopje e noterizuar”.

Gjatë kontrollimit të ofertës së OE fitues, së bashku me personin zyrtar nga AK-ja, kemi vërtetuar se të gjitha referencat dhe pranimet teknike të këtij OE janë të pa noterizuar ose origjinale.

Në njëren nga proceset e pranimit teknik i ka dy kontrata të futura në një proces të pranimit teknik dhe vlera e dyjave veç e veç, nuk arrin vlerën prej 50.000€.

Pas kësaj me 19.11.2015, parashtrojmë ankesë pranë OSHP-së, me pretendimet tona ankimore se AK-MSH-ja, ka bërë shkelje esenciale të LPP-së 04/L-42 dhe atë si në vijim, neni 7, 52, 59, dhe 60 të këtij ligji.

Kompania jonë i ka plotësuar te gjitha kërkesat dhe kriteret e kërkuara në dosje të tenderit.

Kryetari i panelit, pyeti përfaqësuesin e OE ankues, z.Istrefi, se çka mund të thoni për vlerësimin e komisionit për inxhinierin e arkitekturës për z.Asllani, i cili në bazë të CV-së, figuron se nuk është pjesë e OE “Astraplan” dhe figuron se është punëtor në “Euro Projekt”, në përgjigje z.Istrefi deklaroj: pika 9.1, kërkesa mbi mundësitet teknike profesionale kërkohen katër inxhinier, ndërsa, te kërkesa - dëshmitë e kërkuara dokumentare kërkohet, diploma universitare, CV dhe asgjë tjeter.

Ne për të demanduar pretendimin e AK-së, kemi sjell një deklaratë në original nga vet arkitekti z.Asllani, një kontratë mbi bashkëpunimin profesional, letërrjoftimin dhe diplomën e tij , dhe gjitha këto i dorëzoj panelit shqyrtues, që inxhinieri z.Asllani është bashkëpunëtorë i “Astraplan”, që nga viti 2010.

Vërejtja e dhënë nga komisioni vlerësues ka ndodh pas qasjes në dokumente zyrtare nga ana jonë dhe pas ankesës tonë në OSHP, ditën e nesërme kanë përpiluar atë vërejtje ku në mënyrë të jashtëligjshme është kontaktuar vet z.Asllani përmes telefonit dhe atë dy here brenda një ore, ku herën e dytë i është bërë një lloj kërcënimi ku kanë përmend krimet ekonomike, antikorrupsionin etj. Në fund deklaroj se arsyja e vetme e eliminimit ka qenë mos plotësimi referencave.

Në pyetje se çfarë mund të thoni për kërkesën e AK-së, për tri vitet e fundit 2012-2013-2014 OE duhet të dorëzojnë dy referenca me vlerë minimale 50.000€, ndërsa ju keni ofruar një referencë 126.225.84€, në përgjigje z.Istrefi deklaroj: ne në ofertë kemi dorëzuar tri referenca të objekteve shëndetësore ku vlera tyre së bashku arrin vlerën mbi 150.000€, për këtë arsyje nuk kemi pa të arsyeshme të bëjmë kërkesë për heqjen e këtij kushti kufizues nga ana e AK-së, mirëpo ne e kemi plotësuar këtë kusht dhe nuk e kemi pa të arsyeshme të bëjmë kërkesë të tillë.

Kjo vërtetohet shumë lehtë pasi sipas komisionit vlerësues OE fitues ka pas njëjtën gjendje me referenca, një me mbi 50.000€, dhe dy tjera i ka në një proces të vitit 2012 dhe 2013 dhe i ka vlerësuar se i ka përbushur, mirëpo i ka të gjitha të panoterizuar.

I propozojmë panelit të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK – MSH-së, deklaroj se: lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ne si anëtar të komisionit vlerësojmë se kemi vlerësuar drejt dhe konform kritereve të njoftimit për kontratë.

Në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit është specifikuar kriteret, që OE të dorëzojnë së paku dy referenca ose procesverbale të pranimit të punëve të kryera në objektet shëndetësore në tri vitet e fundit ku vlera minimale duhet të jetë 50.000€.

OE “Astraplan”, ka dëshmuar vetëm një projekt me vlerë mbi 120.000.00€, ku nuk plotëson kriterin për dy referenca.

Për stafin është kërkuar të dëshmohen katër inxhinier të kompanisë, ndërsa OE ankues nuk e ka stafin kompanisë së tij, inxhinieri arkitekturës z.Asllani dhe për inxhinieri i makinerisë z.Leku.

Ne si AK, vlerësojmë se OE ankues ka ofruar dëshmi të rrëjshme lidhur me këta dy inxhinier të lartcekur, të cilët nuk janë staf i kompanisë dhe për këtë ofrojmë listën e ATK-së, në kohën e vlerësimit të tenderit, dhe ku shihet se këta dy persona nuk figurojnë në stafin e kompanisë “Astra Plan”, pra z.Asllani është punëtor në “Euro Projekt”.

I propozojmë panelit të refuzohet ankesa e OE ankues dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Gjatë prezantimit në seancë, eksperti shqyrtues, deklaroj: lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues, kam sqaruar në ekspertizë se sipas kërkësës së AK-së, OE ankues nuk i ka ofruar dy referenca mirëpo vetëm një, në ndërtim të objekteve shëndetësore, mirëpo vlera e saj prej 126,225.84€, duke u bazuar në totalin e kësaj referencë mendoj se plotëson kërkësën e AK-së.

Kjo ka qenë arsyja e vetme e eliminimit. Sa i përket pretendimit të AK-së, për inxhinierët, nuk jam marr me këtë pretendim pasi nuk ka qenë arsyetim i eliminimit të OE ankues nga AK-ja.

Në pyetje të kryetarit të panelit se si qëndron e vërteta lidhur me referencat e OE të rekomanduar për kontratë, në përgjigje z.Basha deklaroj: Sipas pikës 6 të vendimit nr.877/15 nuk kam shqyrtuar pretendimet ankimore ndaj OE të rekomanduar pasi ai është me çmim më të shtrenjtë se OE ankues, ndërsa për arsyen e eliminimit nga AK-ja, mendoj se OE ankues e ka plotësuar konform kërkësave të AK-së.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtresës së OE ankues, parashtresës së AK-së, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton dhe vlerëson se OE ankues “Astra Plan”, i ka ofruar kontratat dhe referencat e natyrës se njëjtë dhe fakti që OE ankues e ka dorëzuar një kontratë me vlerë mbi 100,000.00 euro e ka plotësuar kërkësën e AK-së.

Prandaj, paneli shqyrtues, pas diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton dhe vlerëson se AK-ja nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së, pasi që gjatë ekzaminimit, krahasimit, dhe vlerësimit të ofertave, AK-ja, nuk merr për bazë se operatori ekonomik ankues është i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët. Gjithashtu Paneli shqyrtues konstaton se AK-ja, ka nuk e ka respektuar nenin 60 të LPP-së, ku kriteri për dhënie të kontratës është tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike :**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur  
nuk mund të ushtron ankesë,  
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,  
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë  
kërkësë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë  
Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Panelit Shqyrues  
Hysni Hoxha

